



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-044, për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j


Ratifikimin e Marrëveshjes për transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë, e nënshkruar në Budapest, më 9 dhjetor 2015 dhe e pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës më 4 maj 2016.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN – 014 – 2016.

Prishtinë, më 11 maj 2016.



Hashim Thaçi
President i Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË HUNGARISË
PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Hungarisë (këtu e tutje të referuara si Palët Kontraktuese),

Duke dëshiruar që të rregullojnë dhe zhvillojnë transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy shteteve dhe transit përmes territoreve të tyre me kushte reciprociteti dhe në frymën e bashkëpunimit dhe përfitimit të dyanshëm,

Janë pajtuar për sa vijon:

DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1

(1) Dispozitat e kësaj marrëveshjeje i referohen transporti rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave ndërmjet shteteve të Palëve Kontraktuese, të transportit të udhëtarëve dhe mallrave në transit përmes territoreve të shteteve të Palëve Kontraktuese si dhe e transportit të mallrave nga dhe për vendet e treta, që bëhet me autobusë ose kamionë të regjistruara në territorin e njerës Palë Kontraktuese.

(2) Kjo marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo marrëveshje nuk do të ndikojë në obligimet e Hungarisë dhe Republikës së Kosovës drejt Bashkimit Evropian, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga ligji primar dhe ai sekondar i Bashkimit Evropian në lidhje me Hungarinë.

Neni 2

Sipas kësaj marrëveshjeje, termet individuale kanë kuptimin si vijon:

1) "Operator i transportit"
nënkupton çdo person fizik ose juridik (dmth. shoqatë biznesi pa statusin e personit juridik) në Hungari, dmth çdo subjekt në Republikën e Kosovës, i cili është i autorizuar, sipas legjislacionit

kombëtar të Hungarisë, dmth të Republikës së Kosovës për transportin rrugor të udhëtarëve ose të mallrave përmes rrugëve per llogari te vet ose për përfitim,

2) "Autobus"

nënkupton automjetin motorik me lëvizje mekanike për transportin e udhëtarëve, i cili është i përshtatshëm në bazë të kushteve të caktuara teknike për transportin e më shumë se nëntë pasagjerëve, duke përfshirë edhe shoferin, dhe rimorkio për transportin e bagazheve,

3)"Automjet motorik"

nënkupton një automjet motorik me lëvizje mekanike për transportin e mallrave, i cili sipas kushteve të caktuara teknike është i përshtatshëm për transportin e mallrave, duke përfshirë çdo rimorkio shoqëruese apo gjysëm-rimorkio,

4)"Transporti nga apo për në vendin e tretë"

nënkupton transportin e kryer nga një operator i themeluar në shtetin e njëres palë kontraktuese nga territori i një shteti të tretë, në të cilin ky operator nuk është i themeluar në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, si dhe transportin nga territori i shtetit të palës kontraktuese, e që kryhet nga një operator i themeluar në shtetin e palës tjetër kontraktuese në territorin e një shteti të tretë, në të cilën ky operator nuk është themeluar,

5) "Kabotazh"

nënkupton transportin e udhëtarëve ose të mallrave ndërmjet dy vendeve (pikave) në territorin e shtetit të Palës kontraktuese me autobus ose me automjet motorik të regjistruar në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese,

6)"Transit"

- 6.1 nënkupton transportin e udhëtarëve që kryhet nëpër territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese pa të drejtë që të merr apo të zbresë udhëtarë gjatë rrugës ;
- 6.2 Transportin e mallrave me automjet motorik që kryhet nëpër territorin e shtetit të Pales tjetër Kontraktuese pa të drejtë ngarkimi apo shkarkimi të mallit;

7) "Shërbim i rregullt i pasagjerëve"

nënkupton transportin e udhëtarëve me autobus në një rrugë të caktuar me një itinerar të caktuar, në përputhje me rendin e udhëtimit dhe çmimore të përcaktuara, ku udhëtarët merrën dhe zbritën vetëm në pikat e paracaktuara të ndaljes;

8) "Shërbim i posaçëm i rregullt i udhëtarëve"

nënkupton transportin e rregullt me autobus të një grupi të organizuar të udhëtarëve të përcaktuar nga objektivi i udhëtimit, me përjashtim të udhëtarëve tjerë;

9) "Shërbim i kohëpaskohshëm i udhëtarëve"

nënkupton transportin e udhëtarëve me autobus i cili nuk përkufizohet as brenda shërbimi të rregullt të udhëtarëve, as brenda përkufizimit të një shërbimi të posaçëm të rregullt të udhëtarëve;

10) “Ministria kompetente” në Hungari është Ministria e udhëhequr nga Ministri kompetent për transport dhe në Republikën e Kosovës është Ministria kompetent për transport.

II. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3

- (1) Për operimin e shërbimit të rregullt të transportit të udhëtarëve, leja është e nevojshme.
- (2) Lejet për operim në shërbimet e rregullta për transport të udhëtarëve ndërmjet shteteve të Palëve Kontraktuese lëshohen nga autoritetet kompetente të shteteve, secili për pjesën e territorit të vet. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në përputhje me ligjet vendore, bashkërisht përcaktojnë periudhën e vlefshmërisë së lejeve dhe bashkëpunojnë në aprovimin e rendit të udhëtimit, çmimoren dhe itinerarin.
- (3) Kërkesa për lëshimin e lejes së përmendur në paragrafin 2 paraqitet përmes autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese ku operatori është i themeluar për autoritetin kompetent të palës tjetër kontraktuese.
- (4) Kërkesa e përmendur në paragrafin 3 duhet të përfshijë të dhënat si në vijim:
 - 4.1) Emri dhe mbiemri, dmth. emri dhe adresa e operatorit;
 - 4.2) Lloji i transportit;
 - 4.3) Periudha e vlefshmërisë së lejes;
 - 4.4) Periudha e operimit të transportit dhe frekuentimin e projektuar;
 - 4.5) Itinerarin me vend ndaljet (stacionet e autobusëve për marrje dhe zbritje të udhëtarëve, vendpushimet për vozitësit, pikat e kalimit kufitar) ;
 - 4.6) Gjatësia e rrugës në km. në vajtje dhe në kthim;
 - 4.7) Distanca e kaluar për një ditë;
 - 4.8) Koha e vozitjes dhe e pushimit për vozitësit;
 - 4.9) Rendin e udhëtimit;
 - 4.10) Çmimoren (tabela tarifore) dhe kushtet e udhëtimit.

(5) Leja për operim në shërbimet e rregullta për transport të udhëtarëve në transit nëpërmes territorit të shtetit të njërës Palë Kontraktuese lëshohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese përmes territorit të së cilit shtet kalohet në transit.

(6) Bashkë me aplikacionin për lëshimin e lejes për operim në shërbimet e rregullta për transport të udhëtarëve në transit duhet të bashkangjiten edhe të dhënat nga paragrafi 4 të përfshira në nënparagrafet 4.1, 4.2, 4.3, 4.5 dhe 4.9 nga neni në fjalë dhe kopjet e lejes të vendeve ndërmjet të cilave kryhet transporti.

Neni 4

(1) Për shërbimet e kohëpaskohshme nuk është e domosdoshme leja për rastet si në vijim:

1.1) Në transit,

1.2) Ndërmjet territoreve të shteteve të Palëve Kontraktuese, përkatësisht:

1.2.1) Udhëtime me dyer të mbyllura, dmth. transport të kryer me autobusin e njëjtë i cili bartë të njëjtin grup të udhëtarëve gjatë gjithë udhëtimit dhe i sjell ata përsëri në vendin e nisjes që ndodhet në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese ku autobusi është regjistruar dhe përbërja e grupit të udhëtarëve është i pandryshuar gjatë udhëtimit;

1.2.2) Transporti i grupit të njëjtë të udhëtarëve nga vendi i nisjes i cili gjendet në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese ku autobusi është regjistruar deri në vendin e destinacionit i cili gjendet në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe udhëtimi kthyes i zbrazët i autobusit në vendin e nisjes.

(2) Për operimet të udhëtimit të një autobusi i cili zëvendëson autobusin në defekt i cili kryente një lloj transporti të referuar në paragrafin 1 nuk është e nevojshme leja;

(3) Për operimin e shërbimeve të rastit (kohëpaskohshme) e cekura në paragrafin 1 dhe 2 është e nevojshme për të bërë një listë udhëtarësh për çdo udhëtim që gjatë udhëtimit duhet të mbahet vazhdimisht në autobus dhe që me të hyrë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese duhet të vërtetohet nga zyrtarët doganor, me përjashtim kur hynë në territorin e Hungarisë nga territori i një shteti tjetër anëtar të BE-së.

(4) Për operimin e shërbimeve të tjera të rastit (kohëpaskohshme) leja e autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese është e nevojshme. Aplikimi i operatorit për dhënien e lejes paraqitet nëpërmjet autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese ku është themeluar operatori, për autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese, e cila zgjidh kërkesën në afatin sa më të shpejtë.

Neni 5

- (1) Për kryerjen e shërbimit të posaçëm të transportit të rregullt të udhëtarëve është e nevojshme leja. Lejet lëshohen nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, çdo autoritet për pjesën e linjës së autobusit në territorin e vet.
- (2) Kërkesa për dhënien e lejes për shërbimin e posaçëm të transportit të rregullt të udhëtarëve duhet dorëzuar nëpërmjet autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese ku është i themeluar operatori, për autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese. Aplikimi duhet të dorëzohet të paktën brenda afatit prej 60 ditësh para fillimit të kryerjes së transportit.
- (3) Kërkesa për dhënien e lejes për shërbimin e posaçme të transportit të rregullt të udhëtarëve duhet të përmbajë të dhënat e cekura në nën-paragrafët 4.1-4.9 në paragrafin 4 neni 3 (të kësaj Marrëveshjeje).
- (4) Kur kryhen operimet e transportit të posaçme të rregullta të udhëtarëve operatori është i obliguar për përpilimin e listës së udhëtarve të cilën duhet mbajtur vazhdimisht në autobus dhe që me të hyrë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese duhet të vërtetohet nga zyrtarët doganor, me përjashtim kur hynë në territorin e Hungarisë nga territori i një shteti tjetër anëtar të BE-së.

III. TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 6

- (1) Aktivitetet e mëposhtme mund të kryhen me posedimin e lejes të lëshuar paraprakisht nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese:
 - Transporti i mallrave ndërmjet territoreve të shteteve të Palëve Kontraktuese, me një automjet të regjistruar në territorin e shteteve të ndonjëres Palë Kontraktuese, përfshirë transportin e mallrave brenda zonës kufitare,
 - Transporti i mallrave transit nga një operator transporti i themeluar në Hungari përmes territorit të Republikës së Kosovës për një shtet të tretë që nuk është anëtar i BE-së ose nga një Shtet jo-anëtar i BE,
 - Transporti i mallrave transit nga një operator i transportit i themeluar në Republikën e Kosovës nga Republika e Kosovës përmes territorit të Hungarisë në një shtet anëtar të BE-së ose nga një shtet anëtar i BE-së për një destinacion në Republikën e Kosovës,
 - Transporti i mallrave nga ose në një shtet vend të tretë, sipas pikës 4 të nenit 2.
- (2) Një kopje e lejes lëshohet për çdo mjet motorik. Leja lëshohet për vajtje dhe për në kthim, për mjet motorik të ngarkuar apo të pa ngarkuar. Për transport të mallrave me mjet motorik me rimorkio, leja është e domosdoshme vetëm për mjetin motorik.
- (3) Leja e cekur në paragrafin 1 dhe paragrafin 2 mund t'i lëshohet:

3.1) Me pagesën e taksës mbi mjetin motorik në territorin e Hungarisë apo me pagesën e tarifës rrugore në territorin e Republikës së Kosovës;

3.2) Pa pagesën e detyrimeve doganore të përmendura në paragrafin 3.1) të këtij paragrafi,

(4) Ministritë kompetente të Palëve Kontraktuese në kuadër të Komitetit të Përbashkët të përmendur në nenin 16 përcaktojnë llojin, numrin, kushtet për lëshimin dhe përdorimin e lejeve të përmendura në paragrafët 1.2 dhe 3.

(5) Leja për transportin e mallrave është e pa transferueshme, dmth. se mund të përdoret vetëm për mjetin motorik dhe për aktivitete transporti për të cilat edhe është lëshuar dhe nga operatori të cilit i është lëshuar.

(6) Leja e përmendur në paragrafin 1 duhet të mbahet në mjetin motorik gjatë transportit të mallrave në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe të prezantohet, gjatë kontrollit, me kërkesë të autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

(7) Lejet janë valide për vitin kalendarik dhe mund të përdoren përfshirë 31 janarin e vitit në vijim.

Neni 7

Transporti i mallrave mund të kryhet pa posedim të lejes në rastet si në vijim:

- 1) Transporti i materialit për reklamim dhe trajnim (p.sh. për qëllime të ekspozitave apo panaire);
- 2) Transportin e pajisjeve, aksesorëve, dhe kafshëve për shfaqjet teatrale, filmike, muzikore dhe shfaqje cirku, dhe atyre të destinuara për inçizime në radio, apo për produksione filmi apo televizioni;
- 3) Udhëtimi në kthim i mjetve motorike të dëmtuara apo atyre që kanë pësuar defekte;
- 4) Transporti i urnave për varreza dhe arkivole me trupa të pajetë;
- 5) Transporti i ndihmave humanitare;
- 6) Transporti i bagëtive;
- 7) Transporti i mobiljeve të amortizuara;
- 8) Transporti i çështjeve postare;
- 9) Transporti i pjesëve të punës së artit;
- 10) Transporti i bagazhit në rimorkio e autobusëve për transportin e udhëtarëve.
- 11) Transporti i mallrave me mjet motorik pesha totale e lejueshme e ngarkesës përfshirë rimorkion nuk tejkalon 6 ton, apo në rast kur ngarkesa e lejuar duke përfshirë rimorkion nuk tejkalon 3.5 ton;

12) Udhëtimi i parë transit i mjetit motorik të blerë jashtë vendit për operatorin e ndonjërit shtet të Palëve Kontraktuese.

Neni 8

(1) Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese sigurojnë se në rastin e mjeteve motorike të cilave u është dhënë leja për transportin e mallrave në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese që nuk do të zbatohen masa/rregullore të cilat konsiderohen si më të pa favorshme se ato që aplikohen në rastin e mjeteve motorike të regjistruara në shtetin e vet në lidhje me kufijtë e sipërm të dimensioneve të lejueshme dhe të peshës.

2) Në rastet kur dimensionet apo pesha e mjetit motorik apo ngarkesa e tij tejkalonë kufirin e lejuar në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese ku kryhet transporti, është e domosdoshme të merret një leje e posaçme e cila lëshohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese.

3) Leja e cekur në paragrafin 2 mund të përshkruaj kufijtë relevant apo të përcaktojë rrugën dhe pikën e kalimit kufitar të cilën e përdorë.

IV. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 9

(1) Gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve dhe mallrave në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese operatori është i detyruar të respektojë legjislacionin kombëtar të atij shteti.

(2) Në rast se një operator i themeluar në territorin e shtetit të njëjës Palë Kontraktuese shkel ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje ose rregulloret kombëtare në fushën e transportit rrugor të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, autoriteti kompetent në territorin e të cilit është kryer shkelja, përveç zbatimit të procedurave të veta, informon autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese, ku operatori është themeluar, i cili merr masa në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar.

(3) Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese njoftojnë njëra tjetren për masat e ndërmarra të përmendura në paragrafin 2.

Neni 10

(1) Me të hyrë në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese operatori është i obliguar, që të paraqes polisën e sigurimit për palën e tretë me kërkesë të autoritetit kompetent të asaj Pale Kontraktuese.

(2) Në qoftë se operatori nuk posedon dokumentin e përmendur në paragrafin 1 pas hyrjes në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese, operatori është i obliguar në përputhje me rregulloret kombëtare që të lidhë një kontratë për vet-sigurim.

Neni 11

(1) Mjetet motorike e mëposhtme janë të liruara nga pagesa e taksës rrugore në territorin e Republikës së Kosovës ose nga pagesa e tatimit të automjeteve në territorin e Hungarisë:

1.1) Mjetet motorike që kryejnë transportin e mallrave në bazë të kuotave të lejeve të përcaktuara në paragrafin (4) të nenit 6, me përjashtim të mjeteve motorike të përmendura në nënparagrafin (3.1.) të paragrafit 3 të nenit 6,

1.2) Mjetet motorike që kryejnë me transportin e mallrave të përmendur në nenin 7 dhe qarkullimi pa ngarkesë të një mjeti motorik në rastet e transportit të përmendura në nënparagrafët 1.1) -1.11) të paragrafit 1 të nenit 7.

1.3) Autobuset që kryejnë transportin e udhëtarëve ndërmjet territoreve të shteteve të Palëve Kontraktuese apo në transit përmes territorit të shtetit të cilës do Palë Kontraktuese.

(2) Dispozita nga paragrafi 1 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me pagesa, taksa rrugore dhe tarifatat për ura të cilat duhen paguar në pjesë të caktuara të autostradës, për ngasje nëpër zona të caktuara të qytetit, tunele, mbi ura dhe ndërtime të tjera rrugore si dhe për pagesat për transport në rastin e tejkalimeve të dimensioneve, peshës totale të lejueshme dhe / ose ngarkesës boshtore në bazë të legjislacionit kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 12

(1) Me të hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, operatori është i liruar nga detyrimet e importit dhe tarifatat për:

1.1) Karburanti që gjendet në rezervuarët fikse që janë fabrikisht-të projektuar dhe instaluar nga prodhuesi për këtë model të mjetit motorik, që shërben për drejtimin e mjetit, për një mjet motorik dhe një udhëtim;

1.2) Pjesë rezervë dhe vegla që përkohësisht janë importuar në territorin e Republikës së Kosovës në bazë të dokumentit të lëshur apo të vërtetuar nga zyra kompetente e doganës, për riparimin e mjetit të dëmtuar apo mjetit motorik në defekt i cili kryen transportin sipas kësaj marrëveshjeje.

(2) Veglat dhe pjesët e përdorura dhe ato të zëvendësuara të përmendura në nënparagrafin 1.2) të paragrafit 1 duhet të kthehen në shtetin në të cilin është regjistruar mjeti motorik ose të shkatërrohen nën mbikëqyrjen e autoritetit doganor ose ato duhet të trajtohen në pajtim me rregulloret doganore të vlefshme në territorin e Republikës së Kosovës.

(3) Pas hyrjes në territorin e Hungarisë në përputhje me paragrafin (2) të nenit 1, lidhur me transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave me të cilat ndërlidhen dispozitat e kësaj marrëveshjeje, Hungaria siguron mundësitë dhe lejitimet bazuar në rregulloret aktuale doganore të Bashkimit Evropian sipas procedurave dhe rregullave të vendosura në lidhje me detyrimet dhe pagesat me efekte identike si dhe përjashtimin nga kufizimet dhe ndalesat e importit dhe eksportit. Në lidhje me këtë kur të hynë në territorin e Hungarisë, operatori është i liruar nga detyrimet dhe tarifat e efekteve identike për:

3.1) Karburanti që gjendet në rezervuarët fikse të dizajnuar, të projektuar dhe të instaluar nga prodhuesi për të gjitha mjetet motorike apo autobusët e llojit të njëjtë, që shërben për vënie në levizje të mjetit motorik apo autobusit siç është dhënë në kapitullin XXVIII të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1186/2009, për vendosjen e një sistemi komunitar të lirimit nga detyrimet doganore dhe çdo ndryshim të saj.

3.2 Pjesët rezervë dhe veglat që janë importuar përkohësisht në territorin e Hungarisë në bazë të dokumentit të vërtetuar nga zyra doganore e hyrjes dhe me përfundimin e njëkohshëm të formaliteteve përkatëse doganore, të nevojshme për riparimin e mjeteve motorike të dëmtuara ose atyre me defekte gjatë udhëtimit të cilat kryejnë transportin ndërkombëtar sipas kësaj marrëveshjeje,

(4) Pjesët rezervë dhe veglat që janë importuar përkohësisht në territorin e Hungarisë për riparimin e mjeteve motorike ose autobusëve kosovarë, të dëmtuara apo atyre në defekt i cili kryen transportin sipas kësaj marrëveshjeje në territorin e Hungarisë, i caktohet një trajtim i lejuar doganor apo përdorim.

Neni 13

Kabotazhi është i ndaluar, përveç me autorizim të veçantë të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese të shtetit në territorin e të cilit kryhet kabotazhi.

Neni 14

Për sa i përket kontrollit doganor dhe kontrollit të kryer nga shërbimet e inspektimit kufitar, si dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me rregullat veterinarë, epidemike, mjedisore dhe rregullat e mbrojtjes natyrore, palët kontraktuese zbatojnë rregulloret kombëtare ose dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Palët Kontraktuese.

Neni 15

Organet kompetente kufitare të kontrollit të trafikut dhe organet tjera që kryejnë kontrollat të tjera zyrtare në kufijtë e Shtetit, në rastin e transportit të personave të lënduar rëndë, në rastin e transportit të rregullt të udhëtarëve, si dhe në rast të mjeteve motorike transportuese të blegtorisë, mallrave që prishen lehtë apo të rrezikshme, dogana-kufitare, veterinarë dhe fitosanitare, epidemiologjike dhe mbrojtja e mjedisit do të kryejnë kontrollat me prioritet.

Neni 16

(1) Për qëllime të zbatimit dhe aplikimit e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të ngrjenë një Komitet të Përbashkët që do të takohet të paktën një herë në vit ose në raste të jashtëzakonshme me kërkesë të një Ministrie kompetente, me radhë në territorin e shtetit të secilës Palë Kontraktuese.

(2) Në rast nevoje, Komiteti i përbashkët do të propozojë harmonizimin e kësaj marrëveshjeje me zhvillimin e trafikut dhe me marrëveshjet multilaterale të nënshkruara nga të dyja Palët Kontraktuese, dmth, shtetet e tyre.

(3) Komiteti i përbashkët do të bëjë egzaminimin e mundësive të lehtësirave të mëtejme të transportit të mallrave dhe do të elaborojë propozimet përkatëse për Palët kontraktuese.

Neni 17

(1) Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë (30) pas datës së pranimit të njoftimit të fundit me të cilin Palët Kontraktuese njoftojnë njëra tjetrën se kanë kryer procedurat e ratifikimit për këtë marrëveshje në pajtim me legjislacionet kombëtare.

(2) Kjo marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar dhe mund të anulohet nga secila Palë Kontraktuese në mënyrë diplomatike. Në rast të anulimit kjo marrëveshje do të bëhet e pavlefshme gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit për anulim.

E bërë në Budapest me 09.12.2015 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, hungareze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast të mosmarrëveshjes, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS

SË KOSOVËS

Z. Hashim THAÇI

Zëvendëskryeministër i Parë dhe

Ministër i Punëve të Jashtme

PËR QEVERINË

E HUNGARISË

Z. Dr. János FÓNAGY

Ministër Shteti

Ministria e Zhvillimit Kombëtar